



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

FTESË

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **III-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2025.**

Seanca mbahet më **21.03.2025 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Rishqyrtimi i vendimit 01Nr.06-3900/2025 për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake në kategorinë paga dhe mëditje (ref.nga ekz),
5. Rishqyrtimi i vendimit 01Nr.06-3885/2025 për ndryshim-plotësim të vendimit 01Nr.06-31721/2020 për pagesën e shujtave (ref.nga ekz),
6. Rishqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2030 (ref.nga ekz),
7. Rishqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës (ref.nga ekz),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për ndërrimin e titullarit të pronave sipas propozimit (ref.nga drejt. shëndetësisë),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të monitorimit të HZK-së – 2020-2028 (ref. nga DUMM),
10. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë të Komunës së Klinës dhe planin e veprimit për transparencë komunale 2025-2029 (ref. nga grupi punues),
11. Shqyrtimi dhe miratimi draft-rregullores për transparencë e Komunës së Klinës (ref. nga grupi punues),
12. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për transparencë 2025-2029 (ref.nga grupi punues),
13. Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërorë (ref.DSHPE)
14. Pyetje dhe përgjigjeje,

01Nr. 06-7076 2025
Klinë, me 21.03 2025





Na osnovu člana 43, 45. i 47. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, člana 47. Statuta opštine Klina br. 01-110-1232/2010. Član 5 Administrativnog uputstva MAPL br. 02-2015 za održavanje sednica skupštine opštine kao i član 4 Pravilnika o radu Skupštine i opštinskih komisija, predsedavajući Skupštine Opštine, vrši sledeće:

OBAVEŠTENJE

Pozivaju se svi članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da učestvuju na 3 redovnu radnu sednicu Skupštine za 2025 godinu.

Sednica se održava 21.03.2025 (petak), u sali Skupštine opštine Klina sa početkom u 10 časova.

U vezi sa pitanjem neučešća na sednici, referisete se na odredbu člana 39. ZLS.

Za ovu sednicu predložen je ovaj:

DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog odbora,
4. Preispitivanje rešenja 01 br. 06-3900/2025 za prenos sredstava iz ličnih primanja u kategoriju zarada (ref. iz pr.),
5. Razmatranje rešenja 01 br. 06-3885/2025 za izmenu-dopunu rešenja 01 br. 06-31721/2020 za uplatu takse (ref. iz pr.),
6. Razmatranje Lokalnog akcionog plana za životnu sredinu 2025-2030 (ref. iz pr.),
7. Razmatranje uredbe o porezima, taksama i komunalnim naknadama u opštini Klina (ref. iz pr.),
8. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluku direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu za promenu vlasnika imovine po predlogu (ref. Odeljenja za zdravstvo),
9. Razmatranje i usvajanje prijedloga-odluke za odobravanje Izveštaja o praćenju HZK-a - 2020-2028 (ref. od DUMM),
10. Razmatranje izveštaja iz procesa organizovanja javne konsultacije o regulisanju transparentnosti opštine Klina i akcionog plana za opštinsku transparentnost 2025-2029 (ref. od radne grupe),
11. Razmatranje i usvajanje Nacrta uredbe o transparentnosti Opštine Klina (ref. od radne grupe),
12. Razmatranje i usvajanje Akcionog plana za transparentnost 2025-2029 (ref. od radne grupe),
13. Informacije o održavanju puteva i trotoara tokom zimske sezone (ref. DSHPE)
14. Pitanja i odgovori,

01Br. 06-7076 2025
Klina, 11.03 2025

Predsedavajući Skupštine
Edil Gashi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DATË: 05.03.2025

PËR: Z.Fadil GASHI - Kryesues i Kuvendit të Komunës;
Komitetin për Politikë dhe Financa
Kuvendin Komunal të Klinës


PËRMES: Z.Zenun ELIZAJ – Kryetar i Komunës së Klinës

NGA: Agron BACAJ – Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

LËNDA: Kërkesë



Të nderuar,



Siç jeni të informuar, Komuna e Klinës, përkatësisht, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është në proces të realizimit të projekteve në interes të qytetareve, përkatësisht ndërtimin e objektit të ri të Emergjencës apo objektit të Qendres së Mjekësisë Familjare afër Shtëpisë për përkujdesjen e personave të moshuar, në parcelat në Zonën Kadastrale në Dollc, të cilat parcela në regjistrat e pronës, aktualisht, evidentohet në emër të PSh, Shkolla fillore “Dositej Obradoviq”.

Komuna e Klinës, me dokumentin e planifikimit, përkatësisht, hartat zonale, të miratuara në vitin 2020, në parcelën e lartpërmendur ka paraparë ndërtimin e objekteve publike, për nevoja sociale e shëndetësore.

Meqenëse, pronat, sipas certifikatës pronësore, figurojnë si pronë shoqërore e evidentuar në emër të Shkollës Fillore “Dositej Obradoviq”, sipas skicave të viteve 60-ta, kjo pronë ishte e evidentuar pasuri e përgjithshme e Komunës e Klinës, kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa, përkatësisht, Kuvendi Komunal, që si e tillë të evidentohet në emër të Komunës së Klinës me qëllim që të mos na dalin pengesa në realizimin e projekteve komunale.

Shpresojmë që kërkesa jonë do të shqyrtohet dhe të aprovohet dhe prona të evidentohet në emër të Komunës së Klinës pasi që, sipas sistemit juridik të asaj kohe, prona e tillë dhe pronat përreth oborrit të shkollës, ishin evidentuar në emër të shkollës.

Shtojcë: Të bashkëngjitur gjeni certifikatën e pronave

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Përgjigje për kërkesën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Arsimit

06.03.2025

Komuna e Klinës

Përsëndetje,

Orga

unt
nost

03 943-6688/25

Në lidhje me kërkesën tuaj për kalimin e parcelës që ndodhet në emër të Shkollës "Dositej Obradović" në emër të Komunës së Klinës, për ndërtimin e objektit të Shtëpisë për Përkujdesje ndaj Personave të Moshuar, dëshirojmë të ju informojmë se, pas shqyrtimit të kërkesës dhe analizës së mundësive të planifikimit për vitet e ardhshme, Drejtoria e Arsimit nuk ka parashikuar ndonjë projekt ndërtimi në atë parcelë.

Për këtë arsye, ne e aprovojmë kërkesën tuaj dhe jemi të gatshëm të vazhdoni me procedurat për kalimin e tokës në emër të Komunës së Klinës, duke kontribuar kështu në realizimin e projektit të nevojshëm për kujdesin ndaj personave të moshuar.

Me respekt,

Dr.sc. Qemajl Sejdiu

Drejtor i Arsimit në Klinë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

2ptanist

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH.SHKOLLA FILLORE DOSITEJ OBRADOVIQ

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	11-657-2025
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	06.03.2025 - 10:44
Komuna / Opština / Municipality:	KLINË / KLINA / KLINË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KLINË / KLINA / KLINË

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P.SH.SHKOLLA FILLORE DOSITEJ OBRADOVIQ			/	KCID1002807	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinstvi adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
DOLLC / DOLAC / DOLLC			DOLLC	

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71010022-00091-0	KLINË / KLINA / KLINË	Dolce / Dolac / Dolce	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		SELISHTE- MASHINA NJIVA / SELISHTE- MASHINA NJIVA / SELISHTE- MASHINA NJIVA	1402	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-71010022-00092-0	KLINË / KLINA / KLINË	Dolce / Dolac / Dolce	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		SELISHTE- SHKOLA / SELISHTE- SHKOLA / SELISHTE- SHKOLA	4225	Tokë Ndërtimore - Shtëpi-Ndërtese - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Kuca- Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-71010022-00093-0	KLINË / KLINA / KLINË	Dolce / Dolac / Dolce	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		SELISHTE- OBORRI / SELISHTE- OBORRI / SELISHTE- OBORRI	580	Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-71010022-00094-0	KLINË / KLINA / KLINË	Dolce / Dolac / Dolce	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		SELISHTE- OBORRI / SELISHTE- OBORRI / SELISHTE- OBORRI	1602	Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-71010022-00095-0	KLINË / KLINA / KLINË	Dolce / Dolac / Dolce	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		SELISHTE- OBORRI / SELISHTE- OBORRI / SELISHTE- OBORRI	911	Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyrtarisht

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KLINË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dollc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-71010022-00091-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1402
P-71010022-00092-0	Parcelë / Parcela / Parcel	4225
P-71010022-00094-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1602
P-71010022-00093-0	Parcelë / Parcela / Parcel	580
P-71010022-00095-0	Parcelë / Parcela / Parcel	911



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created: Altin Mujaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 06.03.2025

Koha/ Vreme/ Time: 10:48:54

Број парцеле	Број плана Број скице	НАЗИВ ПОТЕСА И ПАРЦЕЛЕ (звано место)	Класа	КУЛТУРА																	
				Њива (ораница)			Врт			Воћњак			Виноград			Ливада (сенокоша)			Пашњак и планина		
				П О В Р Ш И Н А																	
				ha	a	m²	ha	a	m²	ha	a	m²	ha	a	m²	ha	a	m²	ha	a	m²
1	2	3	4	5			6			7			8			9			10		
			-																		
92	у 9	Љелиште Љкола	-																		
			-																		
105	у 9	Љелиште Љелиште дом Дом, кооператива	-																		
91	у 9	Љелиште Машинска станица	3																	14	02
93	у 9	Љелиште Љелиште Љелиште	-																		
94	у 9	Љелиште Љелиште Љелиште	-																		
95	у 9	Љелиште Љелиште Љелиште	-																		
		СТАЊО КРАЈЕМ 1966																		14	02
Износ:																					

619

~~Dolec~~ Dolec

~~Podrinowski~~ T Podrinowski

БРОЈ ЗЕМЉИШНОКЊ. УЛОШКА:

~~Klina~~ Klina

КУЋНИ БРОЈ И УЛИЦА:

ПОСЕДОВНИ ЛИСТ

[illegible]Број 11



8/306/8

ВРАЧЕ

К.О. ДРЧНК

СЕВШТЕ

К.О. ДРЧНК

10/520



01 Nr. 252 - 6707 / 2025
Klinë, datë 07/03/2025

NGA:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z.Enver Berisha
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë
LËNDA:	Kërkesë, për venjë në rënd ditë, miratimin e raportit të monitorimit të HZK-2020-28

-Në mbështetje të nenit 42 pika 1 pika 2 dhe neni 43 pika 5 të UA_ 24/2015 të MMPHI dhe Ligji për Planifikim Hapsinor të Republikës së Kosovës me nr. 04/L-174 , Ligji për Ndertim me nr.04/L-110.dhe Ligji i Procedura administrative.

- Kërkojmë nga **Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë** që të futet si pikë e rendit të ditës (të ndryshme) **miratimi i raportit të monitorimit të Hartës Zonalë të Klinës-2020-28**

Arsyetim:Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes se Mjedisit ne bashkëpunim me drejtorit sektoriale të Komunes duke u bazuar ne bazat ligjore te siper permendur ka formuluar raportin e vlerësimit të monitorimit te HZK-së 2020-2028 dokument i cili është i nevojshme dhe i domosdoshem ti pri rividimit të këtij dokumenti, andaj kërkojme nga KPF të vendoset ne rend ditë të ndryshme me kusht që ti vëhet per miratim ne seancen e radhes të muajit Mars.

Gjithë materiali shtesë i ketij raporti do te ju ofrohet zyrës se kuvendit me kohë ne formen fizike dhe elektronike.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

RAPORTI I VLËRSIMIT TË HZK-së

Raporti i vlerësimit të HZK-së	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA KLINË MUNICIPALITY OF KLINA Nr.No. 052-6772/25 Data-Data-Datum 07.03.2025 Harta Zonale e Klinës Klinë-Klina
Emri i Planit:	
Vendi dhe Data:	
Drejtorja e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit – Klinë	
Drejtori: Enver Berisha	



Hyrje në Raportin e Vlerësimit të HZK-së

Raporti i vlerësimit të Hartës Zhvillimore Komunale (HZK) ofron një analizë gjithëpërfshirëse të zbatimit të strategjive dhe projekteve për zhvillimin e territorit të komunës. Ky dokument shërben si mjet kyç për të vlerësuar progresin dhe efektivitetin e politikave zhvillimore, duke identifikuar sfidat dhe mundësitë për një zhvillim të qëndrueshëm urban dhe rural. Struktura e raportit është e organizuar në kapituj që trajtojnë aspekte si përdorimi i tokës, menaxhimi i burimeve natyrore dhe zhvillimi i infrastrukturës, me analiza të hollësishme të mbështetura nga të dhëna institucionale. Prezantimi teknik është i qartë dhe i kuptueshëm, duke përdorur grafika dhe tabela për të pasqyruar në mënyrë vizuale progresin dhe ndikimin e projekteve.

Raporti ofron një pasqyrë të detajuar mbi gjendjen aktuale të zhvillimit të komunës dhe rekomandon masa konkrete për përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të territorit. Ai synon të rrisë efikasitetin dhe transparencën në zbatimin e politikave zhvillimore, duke garantuar një qasje më të integruar dhe të qëndrueshme për komunitetin.

BAZA LIGJORE PËR MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E HARTËS ZONALE

Në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës, veprimet e monitorimit dhe raportimit të hartës zonale janë mbështetur në disa akte ligjore kyçe. Veçanërisht, këto veprime janë të mbuluara dhe të udhëzuar nga:

1. **Udhëzim administrative mmph nr. 24_2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.**
2. **Ligji për Planifikimin Hapësinor të Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-174)** - Ky ligj përcakton kornizën e përgjithshme për planifikimin dhe zhvillimin hapësinor në Republikën e Kosovës. Neni i ligjit specifikon detyrimet e institucioneve lokale dhe qendrore për të zhvilluar, monitoruar dhe raportuar rregullisht mbi zbatimin dhe efektivitetin e hartave zonale.
3. **Ligji për Ndërtim (Nr. 04/L-110)** - Në përputhje me këtë ligj, autoritetet kompetente kanë detyrimin për të vlerësuar dhe siguruar zbatimin e kritereve të ndërtimit dhe të standardeve urbanistike, të cilat janë të përcaktuara në hartat zonale. Monitorimi i vazhdueshëm është i nevojshëm për të siguruar se zhvillimet e reja janë në përputhje me këto kritere.
4. **Rregullorja për Kriteret dhe Standardet e Planifikimit Hapësinor** - Kjo rregullore shtesë ofron udhëzime specifike mbi implementimin dhe kontrollin e planeve dhe projekteve të ndërtimit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e ndërmarrësve dhe autoriteteve në monitorimin e zbatimit të planeve zonale.
5. **Udhëzimet Administrative për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban** - Përmes këtyre udhëzimeve, zyrtarët dhe institucionet e planifikimit janë të obliguar të mbajnë regjistra të detajuar të të gjitha ndërhyrjeve dhe ndryshimeve në hartat zonale, si dhe të sigurojnë transparencë dhe pjesëmarrje publike në procesin e rishikimit dhe përditësimit të hartave.

Duke u thirrur në këto dokumente ligjore dhe duke iu përmbajtur rregullave dhe kritereve të tyre, monitorimi dhe raportimi i hartës zonale garanton që zhvillimi urban në Klinë të jetë i qëndrueshëm, i kontrolluar dhe në përputhje me objektivat afatgjatë të planifikimit dhe mirëqenies së komunitetit. Implementimi i kësaj bazë ligjore është jetik për të siguruar një zhvillim të balancuar dhe të drejtë hapësinor në tërë territorin komunal.

Përmbajtja :

1. Hyrja

2. Metodologjia.....

2.1 Zbatimi i Metodologjisë në Kontekstin e Hartës Zonale të Klinës.....

3. Gjendja aktuale dhe analiza.....

3.1. Zbatimi i hartës zonale.....

3.2. Ndikimi në zhvillimin urban.....

3.3. Ndikimi ekonomik dhe social.....

3.4. Ndikimi mjedisor.....

4. Sfidat dhe problematik.....

5. Rekomandime.....

6. Përfundim.....

Konkluzione dhe rekomandime.....

1.HYRJA

Raporti i vlerësimit të Hartës Zhvillimore Komunale (HZK) është një instrument kyç për mbikëqyrjen dhe analizimin e implementimit të strategjive zhvillimore në nivelin lokal. Ky raport ka si qëllim vlerësimin e efikasitetit dhe ndikimit të planifikimeve dhe projekteve të hartuara përmes HZK-së, duke shqyrtuar se si janë përdorur burimet dhe cilat janë rezultatet konkrete të arritura deri më tani. Vlerësimi mbulon aspekte të ndryshme, si: zhvillimi infrastrukturor, përdorimi i territorit, menaxhimi i burimeve natyrore, përfshirja e komunitetit në proceset vendimmarrëse dhe kapacitetet institucionale të autoriteteve lokale.

Një fokus i veçantë i këtij raporti është identifikimi i sfidave kryesore që pengojnë realizimin e qëllimeve të HZK-së, si dhe mundësitë për përmirësim dhe optimizim të proceseve të planifikimit dhe zbatimit. Përmes këtij vlerësimi, synohet të ofrohen rekomandime konkrete që do të ndihmojnë në përmirësimin e politikave lokale, për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të cilësisë së jetesës për qytetarët.

Ky raport është i rëndësishëm për të gjithë aktorët që janë të përfshirë në zhvillimin dhe menaxhimin e territorit, duke përfshirë administratën lokale, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilët mund të përdorin këtë informacion për të informuar politikën dhe strategjitë e ardhshme.

2. Metodologjia e Monitorimit të Zbatimit të Hartës Zonale të Komunës së Klinës

Për të siguruar një monitorim efektiv të zbatimit të Hartës Zonale të Komunës së Klinës (HZK), janë përdorur metodat e mëposhtme:

- **Analiza e Dokumenteve Zyrtare të Planifikimit Hapësinor:** Ky hap përfshin shqyrtimin e detajuar të HZK-së dhe dokumenteve të lidhura, për të kuptuar objektivat, politikat dhe rregulloret e përcaktuara për zhvillimin hapësinor të komunës.
- **Krahasimi i Hartës Zonale me Gjendjen Aktuale përmes Inspektimeve në Terren:** Kjo metodë përfshin vlerësimin e përputhshmërisë midis planifikimit të parashikuar në HZK dhe situatës aktuale në terren, duke identifikuar devijimet ose mospërputhjet.
- **Konsultimi me Institucionet Komunale dhe Qytetarët për Sfidat dhe Përfitimet e Zbatimit të Hartës:** Përfshirja e palëve të interesuara është thelbësore për të kuptuar sfidat praktike dhe përfitimet që lidhen me zbatimin e HZK-së, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Zbatimi i Metodologjisë në Kontekstin e Hartës Zonale të Klinës

Në kontekstin e Komunës së Klinës, zbatimi i kësaj metodologjie është i rëndësishëm për të siguruar që zhvillimi hapësinor të jetë në përputhje me objektivat e përcaktuara në HZK. Për shembull, analiza e dokumenteve zyrtare mund të zbulojë nëse rregulloret për zonat e banimit janë duke u respektuar, ndërsa inspektimet në terren mund të identifikojnë ndërtimet pa leje ose shkeljet e tjera. Konsultimet me komunitetin mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe shqetësimeve të qytetarëve lidhur me zhvillimin urban.

Për një monitorim efektiv, është e rëndësishme që Komuna e Klinës të zhvillojë një program të detajuar monitorimi dhe zbatimi, duke përfshirë takime dhe konsultime me të gjitha palët e interesuara, siç rekomandohet në praktikat më të mira të planifikimit hapësinor.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse do të ndihmojë në identifikimin e hershëm të sfidave dhe në marrjen e masave korrigjuese për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të territorit të komunës.

3. Gjendja aktuale dhe analiza

3.1. Zbatimi i hartës zonale

- **Cilat zona janë zhvilluar sipas planifikimit?**

Sipas dokumentit zyrtar të Hartës Zonale të Komunës së Klinës 2020-2028, disa zona janë zhvilluar në përputhje me planifikimin e parashikuar. Këto përfshijnë zonat e banimit dhe ato komerciale, ku janë respektuar destinimet e përcaktuara dhe janë ndjekur udhëzimet për zhvillim.

- **Cilat zona kanë devijime nga plani fillestar?**

Në disa raste, janë evidentuar devijime nga plani fillestar, veçanërisht në zonat periferike, ku janë vërejtur ndërtime që nuk përputhen plotësisht me destinimet e përcaktuara në hartë. Këto devijime mund të jenë rezultat i mungesës së monitorimit adekuat ose zbatimit të dobët të rregulloreve.

- **A ka pasur ndërtime pa leje dhe si janë menaxhuar ato?**

Po, janë identifikuar ndërtime pa leje në disa zona të komunës. Autoritetet komunale kanë ndërmarrë masa për legalizimin ose ndalimin e këtyre ndërtimeve, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe duke synuar të sigurojnë respektimin e planifikimit hapësinor.

3.2. Ndikimi në zhvillimin urban

- **A ka përmirësime në infrastrukturë (rrugë, ndriçim, ujësjellës, kanalizim)?**

Implementimi i hartës zonale ka sjellë përmirësime të dukshme në infrastrukturë, duke përfshirë ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, instalimin e sistemit të ndriçimit publik, zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimit.

- **A janë ruajtur hapësirat e gjelbra sipas planit?**

Në përgjithësi, hapësirat e gjelbra janë ruajtur sipas planit, megjithëse në disa raste janë vërejtur shkelje, si ndërtimet pa leje në këto zona. Autoritetet janë duke punuar për të adresuar këto çështje dhe për të siguruar mbrojtjen e hapësirave të gjelbra.

- **Si ka ndikuar harta zonale në dendësinë e popullsisë dhe shtrirjen urbane?**

Harta zonale ka ndikuar në rritjen e kontrolluar të dendësisë së popullsisë dhe në zgjerimin e shtrirjes urbane, duke përcaktuar zona specifike për zhvillim dhe duke parandaluar zgjerimin e pakontrolluar urban.

3.3. Ndikimi ekonomik dhe social

- **A ka pasur zhvillim ekonomik në zonat e destinuara për biznese?**

Po, zonat e destinuara për biznese kanë përjetuar zhvillim ekonomik, me rritje të investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës, duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së komunitetit lokal.

- **A ka ndikime negative për komunitetet lokale, si mungesa e shërbimeve ose zhvendosja e popullsisë?**

Në disa raste, janë evidentuar ndikime negative, si mungesa e shërbimeve bazë në zona të caktuara ose zhvendosja e detyruar e popullsisë për shkak të projekteve të zhvillimit. Autoritetet po punojnë për të minimizuar këto ndikime dhe për të siguruar mbështetje për komunitetet e prekura.

3.4. Ndikimi mjedisor

- **A janë respektuar kriteret e mbrojtjes së mjedisit?**

Në përgjithësi, kriteret e mbrojtjes së mjedisit janë respektuar gjatë zbatimit të hartës zonale, megjithëse janë evidentuar disa shkelje që kërkojnë vëmendje të mëtejshme.

- **A ka pasur shkatërrim të hapësirave të mbrojtura apo lumenjve?**

Janë raportuar raste të shkatërrimit të hapësirave të mbrojtura dhe ndotjes së lumenjve, kryesisht si rezultat i aktiviteteve ndërtimore dhe mungesës së mbikëqyrjes adekuate.

- **Sa ka ndikuar ndotja nga ndërtimet dhe zhvillimi industrial?**

Ndotja nga ndërtimet dhe zhvillimi industrial ka pasur ndikim negativ në cilësinë e ajrit dhe ujit në disa zona, duke kërkuar masa të menjëhershme për të adresuar këto çështje dhe për të siguruar një mjedis të shëndetshëm për banorët.

Zbatimi i Hartës Zonale të Komunës së Klinës ka sjellë përfitime të konsiderueshme në zhvillimin urban dhe ekonomik, megjithëse mbeten sfida në aspektin e menaxhimit të ndërtimeve pa leje, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurimit të shërbimeve adekuate për të gjitha komunitetet. Monitorimi i vazhdueshëm dhe përfshirja aktive e qytetarëve janë kyçe për të adresuar këto sfida dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

4. Sfidat dhe problematikat në zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës

4.1. Moszbatimi i disa rregulloreve të planifikimit

Një nga sfidat kryesore në zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës është mosrespektimi i plotë i rregulloreve të planifikimit hapësinor. Kjo përfshin raste ku ndërtimet nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara për etazhitetin dhe madhësinë e objekteve. Në një rast të dokumentuar, një zyrtar komunal deklaroi se lejet e ndërtimit ishin lëshuar bazuar në Hartën Zonale të komunës, e cila përcakton saktë etazhitetin deri në nivelin e parcelës.

4.2. Mungesa e mbikëqyrjes efektive nga institucionet

Një tjetër problematikë është mungesa e mbikëqyrjes efektive nga ana e institucioneve përgjegjëse. Kjo çon në ndërtimet pa leje dhe në shkelje të rregulloreve të planifikimit. Në një debat publik të mbajtur në Klinë për Hartën Zonale, u theksua rëndësia e mbikëqyrjes së duhur për të siguruar zbatimin e saktë të planifikimit hapësinor.

4.3. Ndryshimet e paautorizuara në destinimin e zonave

Ndryshimet e paautorizuara në destinimin e zonave përbëjnë një sfidë tjetër. Këto ndryshime shpesh ndodhin për shkak të mungesës së transparencës dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Klinës, është theksuar nevoja për përfshirjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse për të parandaluar ndryshimet e paautorizuara.

4.4. Reagimi i ulët i qytetarëve për denoncimin e shkeljeve

Një sfidë e rëndësishme është reagimi i ulët i qytetarëve në denoncimin e shkeljeve të planifikimit hapësinor. Kjo mund të jetë rezultat i mungesës së informimit ose besimit në institucionet përgjegjëse. Në debatin publik të mbajtur në Klinë, u diskutua rëndësia e rritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve për rolin e tyre në monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale.

Për të adresuar këto sfida, rekomandohet forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes institucionale, përfshirja aktive e qytetarëve në proceset e planifikimit dhe zbatimit, si dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e zhvillimit hapësinor në Komunën e Klinës.

5. Rekomandime për Përmirësimin e Zbatimit të Hartës Zonale të Komunës së Klinës

5.1. Forcimi i monitorimit nga institucionet komunale dhe inspektoratet

Është thelbësore që institucionet komunale dhe inspektoratet të rrisin përpjekjet e tyre në monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale. Kjo përfshin krijimin e ekipeve të posaçme për mbikëqyrje dhe inspektim të rregullt të zhvillimeve ndërtimore, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me planet e miratuara. Për shembull, Komuna e Gllogocit ka themeluar Ekipin Komunal

për Zbatim dhe Monitorim të Hartës Zonale, i cili është përgjegjës për administrimin, zbatimin dhe monitorimin e HZK-së.

5.2. Përditësimi i hartës zonale bazuar në nevojat e reja zhvillimore

Me kalimin e kohës, nevojat zhvillimore të komunës mund të ndryshojnë. Prandaj, është e rëndësishme që Harta Zonale të përditësohet rregullisht për të reflektuar këto ndryshime dhe për të adresuar sfidat e reja.

5.3. Përmirësimi i infrastrukturës në zonat që nuk janë zhvilluar siç është planifikuar

Në zonat ku zhvillimi ka qenë i ngadalshëm ose ka devijuar nga plani, duhet të ndërmerren masa për përmirësimin e infrastrukturës bazë, si rrugët, ndriçimi publik, ujësjellësi dhe kanalizimi. Kjo do të inkurajojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe do të përmirësojë cilësinë e jetës për banorët. Për shembull, Plani i Veprimit për Qytet të Gjellbër i Prishtinës përfshin masa për përmirësimin e infrastrukturës në zonat e pazhvilluara.

5.4. Krijimi i një mekanizmi për raportimin dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje

Për të luftuar ndërtimet pa leje, është e nevojshme të krijohen mekanizma efektivë për raportimin dhe parandalimin e tyre. Kjo mund të përfshijë platforma online për denoncimin e shkeljeve dhe fushata ndërgjegjësimi për qytetarët mbi rëndësinë e respektimit të rregulloreve të ndërtimit. Për shembull, në një raport mbi sfidat në planifikimin dhe menaxhimin hapësinor në Kosovë, është theksuar nevoja për përfshirjen e shoqërisë civile në monitorimin e zbatimit të ligjit.

5.5. Sensibilizimi i qytetarëve për të ndjekur rregullat e planifikimit hapësinor

Është e domosdoshme të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e respektimit të rregullave të planifikimit hapësinor. Kjo mund të arrihet përmes fushatave informuese, punëtorive dhe bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile. Për shembull, Rrjeti i OJQ-ve Avonet ka identifikuar çështje që kërkojnë ndërhyrje për të përmirësuar zbatimin e rregulloreve të planifikimit.

Duke zbatuar këto rekomandime, Komuna e Klinës mund të përmirësojë ndjeshëm zbatimin e Hartës Zonale, duke siguruar një zhvillim urban të qëndrueshëm dhe në përputhje me nevojat e komunitetit.

6. Përfundim

Bazuar në analizën e bërë, harta zonale e Komunës së Klinës ka pasur një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e qytetit, por ka edhe sfida të cilat kërkojnë përmirësime të vazhdueshme. Rekomandohet që autoritetet komunale të marrin masa për rritjen e kontrollit dhe transparencës në procesin e planifikimit dhe zbatimit të hartës zonale

LISTA KONTROLLUESE KOMPONENTI 1: VLERESIMI I PERMBAJTJES SE HZK-së

1.1. Kushtet e përgjithshme	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Shfrytëzimet e tokës			1			1	33%	Meqense HZK ka percaktuar kriteret e shfrytëzimit gjate zbatimit kemi hasur shum pengesa te cilat kan sjell mos zhvillim, duhet ndryshohet.
K.2 Qasja në parcelën kadastrale			1			1	33%	Duke u bazuar ne shfrytëzimin e tokes edhe qasja ne parcelen kadastrale eshte zbatuar pjeserisht.
K.3 Qasja në infrastrukturë teknike			1			1	33%	Duke u bazuar ne shfrytëzimin e tokes edhe qasja ne infrastrukturen teknike eshte zbatuar pjeserisht.
K.4 Parkimi dhe shkarkimi			1			1	33%	Ky kriter ka zbatushmeri te knaqshme
K.5 Pejshazi dhe shiritat mbrojtës			1			1	33%	Ky kriter nuk ka zbatushmeri te mjaftueshme.
K.6 Ndriçimi natyror dhe artificial				2		2	67%	Ndriqimi natyore eshte I mjaftushem ndersa aj artificial nuk ka zbatushmeri te mjaftueshme
K.7 Zvogëlimi i zhurmës				2		2	67%	Është i zbatushem në mase të duhur
K.8 Formësimi arkitektonik				2		2	67%	Ndërtesa ka disa elemente të përshtatshme, por mund të harmonizohet më mirë me kontekstin urban sipas hartës zonale.
K.9 Eficienca e energjisë		0				0	0%	Nuk është kriter i rëndësishëm në këtë zonë, por mund të konsiderohen masa për kursimin e energjisë.
K.10 Mbrojtja nga zjarri					3	3	100%	Objektet plotësojn standardet e sigurisë nga zjarri, një kriter kyç në këtë zonë.
K.11 Mbrojtja e mjedisit			1			1	33%	Masa të kufizuara për mbrojtjen e mjedisit; mund të përmirësohet me materiale ekologjike dhe menaxhimin e ujërave.
K.12 Qasja e personave me aftësi të kufizuara			1			1	33%	Prezente në nivel minimal; duhen përmirësime për akses të plotë.
Nëntotali 1. Kushtet e përgjithshme						16	44%	
1.2. Përcaktimi i zonave	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Përcaktimi i zonave dhe zonave mbishtresore			1			1	33%	Zonimi dhe shtresimi nuk janë plotësisht të përshtatura me kërkesat e hartës zonale, duke krijuar mundësi për një planifikim më të mirë hapësinor.
K.2 Dendësia dhe sasia e tokës për të akomoduar zhvillimin e ardhshëm			1			1	33%	Përdorimi i tokës nuk është optimal për zhvillimin e ardhshëm; duhen rishikuar kapacitetet e ndërtimit dhe balancimi me infrastrukturën ekzistuese.
Nëntotali 2. Përcaktimi i zonave						2	33%	

1.3. Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore për zonë	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
V.1 Madhësia e parcelës (parcelim – riparcelim)			1			1	33%	Madhësia e parcelës dhe procesi i parcelimit janë të rëndësishme për të garantuar përdorimin efektiv të tokës dhe për të respektuar rregullat e planifikimit urban. Vlerësimi aktual tregon se ky aspekt ka arritur një ngecje. Të monitorohet dhe rishikohen madhësitë e parcelave për të siguruar që ato përputhen me nevojat e zhvillimit urban dhe me kërkesat ligjore, duke marrë parasysh ndryshimet e mundshme në ligjet ose në planifikimin urban.
V.2 Vija e përparme e parcelës (balli i parcelës)			1			1	33%	Vija e përparme e parcelës është kritike për të siguruar një ndërtim të rregullt dhe harmonizimin e strukturave brenda një zone të caktuar. Vlerësimi prej 33% tregon se ka një nevojë për përmirësim në këtë aspekt. Rishikoni dhe përshtatni vijat e përparme të parcelave për të përmirësuar estetikën dhe funksionalitetin e hapësirave urbane. Kjo mund të përfshijë rregullime në planifikimin e ndërtimeve ose një rishikim të rregullave dhe udhëzimeve të planifikimit për të pasqyruar më mirë qëllimet e zhvillimit urban.
V.3 Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN) dhe Indeksi i shfrytëzimi të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZH)			1			1	33%	ISN - i ulët i sipërfaqes së ndërtuar tregon që ka mungesë zhvillimi, hapësirat nuk po shfrytëzohen në mënyrë efikase. Kjo ka çuar në përhapje të pakontrolluar të ndërtimeve dhe në mungesë të hapësirave të ndërtuara në përputhje me nevojat urbane. ISHPKZH -është vlerësuar me 1, kjo tregon që një pjesë e madhe e parcelave kadastrale nuk janë shfrytëzuar si duhet, se ka kufizime të tepërta që po e pengojnë zhvillimin e balancuar të qytetit.
V.4 Vija ndërtimore dhe distanca në mes të ndërtesave			1			1	33%	Mosrespektimi i vijës ndërtimore – Në disa zona të Klinës, ndërtimet nuk janë në përputhje me planet urbanistike, duke krijuar mungesë harmonie në strukturën urbane dhe pengesa në infrastrukturën rrugore. Distanca të papërshtatshme mes ndërtesave – Disa ndërtime janë shumë afër njëra-tjetrës, duke shkaktuar probleme me ndriçimin natyral, ventilimin dhe qasjen në hapësira publike. Në anën tjetër, ka zona ku distancat janë të mëdha, duke krijuar përdorim joefikas të hapësirës urbane.
Zonat								
Zona e banimit								
K.1 Kategorizimi në nënzona sipas dendësisë së banimit	0					0	0%	Mungon vlerësimi (0%), ndoshta duhet të plotësohet.

K.2 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Ka një nivel vlerësimi, por mbulimi është i ulët
K.3 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	Po ashtu, ka një vlerësim, por mbulimi mund të jetë i pamjaftueshëm.
Zonë komerciale							
K.1 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Ka një vlerësim, por mbulimi është i kufizuar.
K.2 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	E njëjta situatë si më lart, zhvillimi mund të ketë kufizime.
Zona industriale							
K.1 Kategorizimi në nënzona sipas llojit të industrisë			1		1	33%	Vlerësuar pjesërisht, mund të kërkojë më shumë analizë.
K.2 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Shfrytëzimi duket i kufizuar, ndoshta duhet të vlerësohet më gjerë.
K.3 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	Po ashtu, me një mbulim të ulët
Zona bujqësore							
K.1 Kategorizimi në nënzona sipas kualitetit të tokës dhe agrozonimit				2	2	67%	Mbulim më i lartë, sugjeron një vlerësim më të plotë.
K.2 Shfrytëzimi i tokës				2	2	67%	Po ashtu, duket se është vlerësuar më mirë.
K.3 Kushtet zhvillimore				2	2	67%	Ka një analizë më të mirë, por mund të nevojiten më shumë detaje për kushtet specifike.
Zonë për shfrytëzim të përzier							
K.1 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Pjesërisht i vlerësuar, por mund të ketë më shumë larmi në realitet.
K.2 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	E vlerësuar në një nivel të kufizuar, mund të shtohet më shumë analizë.
Zonë e shërbimeve							
K.1 Kategorizimi në nënzona sipas llojit të shërbimit			1		1	33%	Vlerësimi duket i pjesshëm, mund të thellohet analiza-ngase zona e percaktuara sipas HZK nuk janë zhvilluar po ashtu është kërkuar zhvillim në zonat tjera.
a) Shërbimet e komunitetit (infrastruktura publike)							
K.2 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Pjesërisht e vlerësuar, mund të ketë hapësirë për përmirësim.
K.3 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	Po ashtu, me vlerësim të kufizuar.
b) Shërbimet e kulturore, argëtuese dhe rekreative (infrastruktura sociale)							
K.4 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Duhet të specifikohet lloji i shfrytëzimit të tokës për këto shërbime.
K.3 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	Të përcaktohen rregulloret dhe kufizimet për ndërtimet që lidhen me këto shërbime.
Infrastruktura teknike (shërbimet publike)							
K.1 Kategorizimi sipas llojit të shërbimit			1		1	33%	Kategorizimi duhet të përputhet me nevojat e komunitetit.

K.2 Rrjeti i ujësllësit dhe i kanalizimit			1		1	33%	Përmirësimi i rrjetit mund të jetë thelbësor.
K.3 Rrjeti i ujitjes			1		1	33%	Nëse ka zona bujqësore, nuk është ky rrjet i mjaftueshëm për nevojat e fermerëve
K.4 Rrjeti i energjisë elektrike			1		1	33%	Plan për përmirësimin e rrjetit elektrik,
K.5 Rrjeti i telekomunikacionit			1		1	33%	Të shqyrtohet cilësia e mbulimit me internet dhe shërbimet telefonike, sidomos në zonat më periferike.
K.6 Rrjeti i deponimit dhe infrastrukturës së grumbullimit të mbeturinave		0			0	0%	Nuk është adresuar ende.
Zonë e komunikacionit-transportit							
K.1 Kategorizimi në nënzona			1		1	33%	Ndarja e zonave e bazuar në fluksin real të trafikut dhe nevojat e transportit publik
K.1.1 Kategorizimi dhe profilizimi i rrugëve publike		0			0	0%	
K.1.2 Stacionet e rrjetit hekurudhor		0			0	0%	Nuk ka plan për zhvillimin e tyre
K.1.3 Transporti ajror	Nuk aplikohet				0	0%	Nuk aplikohet
K. 1.4 Transporti publik			1		1	33%	Nukjanë të mjaftueshme linjat e transportit public, ka hapësirë për përmirësim, sidomos në lidhjen me zonat rurale.
K.1.5 Vendparkimet publike			1		1	33%	Vendparkime të mjaftueshme për të akomoduar fluksin e automjeteve, sidomos në qendër.
K.2 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	
K.3 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	Të sqarohen kufizimet dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm të infrastrukturës së transporti
T.6 Numri i parkingjeve për objektet shumë-banesore				2	2	67%	Ka nevojë për përmirësime ose se ky faktor nuk është plotësisht i përmbushur sipas kërkesave.
Zonë rekreative-turistike							
K.1 Kategorizimi i zonës në nënzona sipas llojit të turizmit apo karakterit zhvillimor		0			0	0%	Mungon kategorizimi i zonave turistike, që tregon se nuk ka një plan të qartë për zhvillimin e turizmit në Klinë. Kjo mund të ndikojë negativisht në potencialin ekonomik dhe promovimin e turizmit rural.
K.2 Shfrytëzimi i tokës		0			0	0%	Nuk ka asnjë shfrytëzim të planifikuar të tokës për qëllime rekreative-turistike, duke humbur mundësi për zhvillim të sektorit të turizmit.
K.3 Kushtet zhvillimore		0			0	0%	Nuk ka rregulla të përcaktuara për ndërtimet ose infrastrukturën që do të mbështeste zonat turistike.
Zonë ushtarake-sigurisë							

K.1 Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore	nuk aplikohet				0	0%	Kjo zonë nuk është e aplikueshme për këtë komunë dhe nuk ka vlerësim.
Zonë pyjore							
K.1 Shfrytëzimi i tokës			1		1	33%	Vetëm një pjesë e vogël e pyjeve është e menaxhuar dhe e përdorur sipas planeve urbanistike.
K.2 Kushtet zhvillimore			1		1	33%	Ka rregulla bazike për mbrojtjen e zonave pyjore, por nuk janë të mjaftueshme për një mbrojtje efektive të mjedisit.
Zonë-minierë sipërfaqësore							
K.1 Shfrytëzimi i tokës				3	3	100%	Menaxhimi i zonave minerare është në nivel maksimal, duke treguar një planifikim të mirë të këtij sektori
K.2 Kushtet zhvillimore				3	3	100%	Kushtet për shfrytëzimin dhe zhvillimin e kësaj zone janë të përcaktuara dhe të zbatuara në mënyrë të rregullt.
Sipërfaqe ujore							
K.1 Kategorizimi i sipërfaqeve ujore sipas llojit të pasurisë ujore dhe statusit juridik			2		2	67%	Ka një nivel të mesëm të kategorizimit të burimeve ujore, por ka ende nevojë për përmirësime në aspektin ligjor dhe zhvillimor.
K.2 Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore			2		2	67%	Shfrytëzimi i burimeve ujore është i kufizuar dhe nuk është plotësisht i optimizuar për nevoja bujqësore apo rekreative
Zonat mbishtresore							
Zonë e mbrojtur / e veçantë/ e veçantë e mbrojtur							
K.1 Shfrytëzimi i tokës			2		2	67%	Zona të mbrojtura ekzistojnë, por ka hapësirë për përmirësim në aspektin e menaxhimit dhe ruajtjes së tyre.
K.2 Kushtet zhvillimore			2		2	67%	Rregullat për mbrojtjen e këtyre zonave janë të qarta, por ka nevojë për më shumë monitorim dhe zbatim të rreptë.
Zonë e trashëgimisë kulturore							
K.1 Kategorizimi i trashëgimisë kulturore sipas llojit dhe statusit të mbrojtjes së vlerës			2		2	67%	Zonat e trashëgimisë kulturore janë kategorizuar, por ka mungesë të investimeve për mbrojtjen e tyre.
K.2 Shfrytëzimi i tokës			2		2	67%	Përdorimi i tokës për zhvillimin e këtyre zonave nuk është maksimal dhe ka nevojë për projekte të reja rigjeneruese.
K.3 Kushtet zhvillimore			2		2	67%	Disa nga këto zona kanë kushte të përcaktuara mirë, por ka ende mungesë të mbështetjes institucionale.
Zonë e ndikuar nga vërshimet							
K1. Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore	0				0	0%	Nuk ka asnjë plan të qartë për menaxhimin e zonave të rrezikuara nga përmytjet. Kjo është

								një mangësi e madhe, pasi rreziku i përmbajtjeve mund të ketë ndikim të madh në zonat e banuara dhe bujqësore.
Zonë e ndikuar nga erozioni								
K1. Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore			1			1	33%	Është identifikuar një nivel i ulët i masave mbrojtëse ndaj erozionit. Kjo tregon se nevojiten strategji më të qarta për parandalimin dhe menaxhimin e erozionit.
Zonë e ndikuar nga tërmetet								
K.1 Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore				2		2	67%	Ka disa masa për ndërtimin në zonat me rrezik nga tërmetet, por ka hapësirë për përmirësim
Zonë e ndikuar nga ortelet dhe erërat e forta								
K.1 Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore	nuk aplikohet					0	0%	Nuk është e aplikueshme për këtë komunë.
Zonë endemike								
K.1 Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore	nuk aplikohet					0	0%	Nuk është e aplikueshme për këtë komunë.
Nëntotali 3. Shfrytëzimi i tokës dhe kushtet zhvillimore për zonë						61	36%	
1.4 Vendbanimet joformale	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Vendbanimet joformale					3	3	100%	Komuna ka bërë vlerësime të plota për vendbanimet informale, duke i identifikuar dhe monitoruar ato.
Nëntotali 4. Vendbanimet joformale						3	100%	
1.5 Planet Rregulluese të Hollësishme (PRrH)	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Planet Rregulluese të hollësishme		0				0	0%	Nuk ka plane rregulluese të hollësishme të miratuara ose të zbatuara. Është urgjente hartimi dhe miratimi i planeve rregulluese për zhvillimin e qytetit dhe zonave rurale.
Nëntotali 5. Planet Rregulluese të Hollësishme (PRrH)						0	0%	
1.6 Plani i veprimit	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Elementet përbërëse			1			1	33%	Ka një kuadër të pjesshëm për planin e veprimit, por mungojnë disa elemente thelbësore.
K2. Ndërlidhja			1			1	33%	Planifikimi nuk ka një lidhje të plotë me strategjitë dhe dokumentet e tjera zhvillimore.

K.3 Mundësi reale për zbatim			1			1	33%	Ekziston një bazë, por mungojnë burimet e duhura financiare dhe teknike për ta zbatuar plotësisht.
Nëntotali 6. Vlerësimi i planit të veprimit						3	33%	
1.7 Dispozitat për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1. Sistemi për monitorim të zbatimit të planit			1			1	33%	Ekziston një sistem monitorimi, por është i kufizuar në funksionalitetin e tij. Të krijohet një sistem më i avancuar monitorimi për të vlerësuar në mënyrë të rregullt zbatimin e planeve zhvillimore.
Nëntotali 7. Dispozitat për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së						1	33%	
1.8 Bonuset e zonimit	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Bonuset e zonimit		0				0	0%	Harta Zonale e Komunës së Klinës 2020-2028 synon të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës.
Nëntotali 8. Bonuset e zonimit						0	0%	
1.9 Jokonformitetet	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Jokonformitetet		0				0	0%	Nuk janë identifikuar jokonformitete.
Nëntotali 9. Jokonformitetet						0	0%	
1.10. Vlerësimi strategjik mjedisor (VSM)	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Vlerësimi i përputhshmërisë së zhvillimeve të zonave të përcaktuara me HZK-së me objektivat e VSM-së				2		2	67%	Ka masa të caktuara për ndikimin mjedisor, por jo të plota. Të rritet integrimi i masave për mbrojtjen mjedisore dhe të forcohet zbatimi i tyre.
K.2 Përfshirja e masave nga analiza e efekteve të mundshme në mjedis si rezultat i zbatimit të HZK-së				2		2	67%	Vlerësimi prej 67% tregon se ka një përfshirje të pjesshme të masave për analizimin e ndikimeve mjedisore të zbatimit të HZK-së. Disa masa janë marrë parasysh, por nuk ka një sistem të plotë për monitorimin dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis. Te behet krijimi i një plani të qartë për menaxhimin e ndikimeve mjedisore në fazat e zbatimit.
Nëntotali 9. Vlerësimi strategjik mjedisor (VSM)						4	67%	
TOTALI PËR SEKSIONIN 1: NËNTOTALI 1+NËNTOTALI 2+NËNTOTALI 3+NËNTOTALI 4+NËNTOTALI 5+NËNTOTALI 6+NËNTOTALI 7+NËNTOTALI 8+NËNTOTALI 9						90	37%	

LISTA KONTROLLUESE KOMPONENTI 2. PËRPUTSHMËRIA

Kriteret për vlerësim	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
2.1 Përputhshmëria me politika dhe kontekst lokal	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Përputhshmëria me PZHK		0				0	0%	Nuk ka përputhshmeri
K.2 Përputhshmëria me strategji dhe plane veprimi lokale sektoriale			1			1	33%	Ka një shkallë të ulët përputhshmërie me politikat lokale.
K.2 Përputhshmëria me strategji dhe plane veprimi lokale sektoriale			1			1	33%	Duhet të forcohet koordinimi ndërmjet planeve zhvillimore dhe strategjive lokale për një qasje më koherente.
Nëntotali 2.1. Përputhshmëria me politika dhe kontekst lokal						2	22%	3
2.2 Përputhshmëria me politika nacionale	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.4 Përputhshmëria administrative-procedurale			1			1	33%	Proceset administrative dhe procedurat për miratimin dhe zbatimin e Hartës Zonale kanë një nivel të pjesshëm përputhshmërie. Ka disa boshllëqe në koordinimin ndërmjet institucioneve dhe mungon një sistem i qartë i përgjegjësisë. Duhet të krijohen udhëzime më të detajuara për procedurat administrative dhe të sigurohet një qasje më e unifikuar mes institucioneve për të shmangur vonesat dhe keqkuptimet në zbatim.
K.5 Përputhshmëria me Hartën Zonale të Kosovës dhe Planet hapësinore për zonat e veçanta			1			1	33%	Duhet të rishikohet Harta Zonale në raport me dokumentet kombëtare dhe të sigurohet një koordinim më i mirë me nivelet e ndryshme të planifikimit hapësinor për të shmangur konfliktet dhe mbivendosjet në zonifikim.
K.6 Përputhshmëria me strategjitë dhe politikat tjera sektoriale të Qeverisë			1			1	33%	Aktualisht, ka një nivel të pjesshëm përputhshmërie mes HZK-së dhe strategjive sektoriale të Qeverisë. Disa plane janë marrë parasysh, por nuk ka një ndërlidhje të plotë me politikat sektoriale si zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit apo infrastruktura. Rekomandim: Nevojitet një analizë më e thellë për të

								siguruar që Harta Zonale të harmonizohet me strategjitë sektoriale të Qeverisë. Gjithashtu, duhet të krijohet një mekanizëm periodik i rishikimit dhe përditësimit të dokumenteve planifikuese në përputhje me prioritetet kombëtare.	
Nëntotali 2.2. Përputhshmëria me me politika nacionale							3	33%	3
TOTALI SEKSIONI 2: NËNTOTALI 1+NËNTOTALI 2							7	26%	

LISTA KONTROLLUESE KOMPONENTI 3: PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT – PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT

Kriteret për vlerësim	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment
	nuk aplikohet	0	1	2	3			
K.1 Identifikimi dhe mobilizimi i të gjitha palëve të interesit			1			1	33%	Ka një nivel të pjesshëm të përfshirjes së palëve të interesit në procesin e hartimit të HZK-së. Janë identifikuar disa grupe kyçe, por nuk ka një mobilizim të gjerë të komunitetit, investitorëve privatë dhe shoqërisë civile. Duhet të zhvillohen mekanizma më të strukturuar për angazhimin e të gjitha palëve të interesit që nga fazat e hershme të planifikimit, duke përfshirë takime të hapura, forume konsultative dhe fushata informuese për qytetarët.
K.2 Pjesëmarrja në fazat e rëndësishme të procesit			1			1	33%	Pjesëmarrja publike është bërë në disa faza të procesit të hartimit të HZK-së, por ka mungesë transparence dhe përfshirje të plotë në vendimmarrje. Qytetarët dhe grupet e interesit nuk janë përfshirë plotësisht në diskutimet kyçe. Nevojitet forcimi i pjesëmarrjes publike në çdo fazë të rëndësishme të planifikimit duke përdorur mjete interaktive si sondazhet online, dëgjimet publike dhe platformat digjitale për marrjen e komenteve.
K.3 Shqyrtimi publik			1			1	33%	Shqyrtimi publik është bërë, por me pjesëmarrje të kufizuar dhe pa ndikim të madh në vendimet përfundimtare. Ka mungesë të një qasjeje efektive për informimin dhe angazhimin e

								qytetarëve. Duhet të zhvillohen më shumë seanca informuese dhe konsultime publike, si dhe të sigurohet që komentet e qytetarëve dhe grupeve të interesit të kenë ndikim të vërtetë në procesin e planifikimit.	
TOTALI SEKSIONI 3: PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT							3	33%	
LISTA KONTROLLUESE KOMPONENTI 4. ÇËSHTJET TEKNIKE									
Kriteret për vlerësim	Kategoritë e vlerësimit					Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	Koment	
	nuk aplikohet	0	1	2	3				
Struktura dhe vëllimi i dokumentit					3				
K.1 Struktura e dokumentit					3	3	100%	Struktura e dokumentit është shumë e organizuar, çka e bën të lehtë ndjekjen e informacioneve.	
K.2 Vëllimi i dokumentit					3	3	100%	Vëllimi i informacionit është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të mbuluar çështjet kyçe.	
Nëntotali 1. Struktura dhe vëllimi i dokumentit						6	100%		
Gjuha e përdorur									
K.3 Thjeshtësia e gjuhës së përdorur				2		2	67%	Gjuha është relativisht e thjeshtë për një dokument teknik, megjithatë mund të përmirësohet për të rritur qartësinë.	
K.4 Gabimet gjuhësore dhe teknike				2		2	67%	Janë të pranishme disa gabime që mund të pengojnë mirëkuptimin e plotë të tekstit.	
Nëntotali 2. Gjuha e përdorur						4	67%		
Prezantimi teknik									
K.5 Paraqitja e të dhënave			1			1	33%	Të dhënat janë të paraqitura, por jo mjaftueshëm për të mbuluar çdo aspekt të nevojshëm. Zgjerohet përfshirjen e të dhënave dhe paraqitjen grafike për të mbuluar më mirë nevojat informative.	
K.6 Paraqitja grafike			1			1	33%	Grafikët janë të përfshirë, por numri i tyre është i kufizuar. Te shtohen më shumë grafikë dhe diagrama që ndihmojnë në vizualizimin e të dhënave dhe të lehtësojnë kuptimin e informacioneve.	
Nëntotali 3. Prezantimi teknik						2	33%		
TOTALI PËR SEKSIONIN 4: NËNTOTALI 1+NËNTOTALI 2+NËNTOTALI 3						12	67%		

Konkluzioni	Vlerësimi	Pesha e poentimit (%)	NËNTOTALET
Vlerësimi i seksionit 1: VLERËSIMI I PËRMBAJTJES SË HZK-së	90	37%	NËNTOTALI 1: XXX % (max. 243)
Vlerësimi i seksionit 2: PËRPUTHSHMËRIA	7	26%	NËNTOTALI 2: XXX % (max.27)
Vlerësimi i seksionit 3: PROCESI I HARTIMIT TË HZK-së	3	33%	NËNTOTALI 3: XXX % (max. 9)
Vlerësimi i seksionit 4: ÇËSHTJET TEKNIKE	12	67%	NËNTOTALI 4: XXX % (max.18)
TOTALI: NËNTOTALI 1+NËNTOTALI 2+NËNTOTALI 3+NËNTOTALI 4	112	38%	

0% - 29%: i papranueshëm, ka nevojë për përmirësim drastik;
30% - 49%: ka nevojë për përmirësime të dukshme
50% - 69%: plotëson deri në masë mesatare kriteret e vlerësimit;
70% - 89%: plotëson kriteret e vlerësimit deri në masë të madhe
90% - 100%: plotëson të gjitha kriteret

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR RISHIKIMIN E KUSHTEVE ZHVILLIMORE NË HARTËN ZONALE TË KLINËS

Në përgjigje të ankesave të vazhdueshme të palëve interesuar mbi kushtet zhvillimore në shumicën e zonave të Klinës dhe konstatimeve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilat theksojnë se këto ankesa janë të bazuara dhe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, rekomandohet një rishikim i thellë dhe gjithëpërfshirës i kushteve zhvillimore. Ky rishikim synon të adresojë dhe të përmirësojë kritere bazë të planifikimit urban dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Rekomandime Specifike:

1. Rivlerësimi i Madhësisë së Parcelës: Përshtatja e kritereve për madhësinë e parcelës për të reflektuar nevojat aktuale të zhvillimit urban dhe të densitetit të popullsisë.
2. Rishikimi i Etazhësisë: Vendosja e kritereve të reja për etazhësinë që variojnë në varësi të madhësisë së parcelës dhe karakteristikave të zonës.
3. Largësia Maksimale dhe Barazia Zonale: Standardizimi i largësisë nga kufijtë anësorë dhe pasëm të parcelave për të garantuar uniformitet dhe barazi në trajtimin e zonave me perimetër të afërt.
4. Rishikimi i Indeksit të Shfrytëzimit të Parcelës (ISN): Përshtatja e këtij indeksi për të përmirësuar shfrytëzimin e hapësirës dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.
5. Përcaktimi i Kushteve të Sutereneve: Vendosja e kritereve të qarta për përfshirjen e sutereneve në projektet e ndërtimit, të cilat aktualisht mungojnë ose janë të paqarta.
6. Ridestnimi i Zonave dhe Ripërcaktimi i Hartës Zonale: Rishikimi dhe, ku është e nevojshme, ridestnimi i zonave që aktualisht nuk kanë zbatueshmëri praktike, duke përfshirë edhe ripërcaktimin e hartës zonale për ato nën-zona ku zhvillimi ka devijuar nga parashikimet aktuale.

Këto rekomandime synojnë të sigurojnë një planifikim më të detajuar dhe të qëndrueshëm, të bazuar në një analizë të plotë dhe të kujdesshme të nevojave të komunitetit dhe të zhvillimit urban. Implementimi i tyre do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët e Klinës dhe do të promovojë një zhvillim më harmonik dhe të qëndrueshëm urban.

2024

Ministria e Financave / Ministarstvo za
Ministry of Finance
Arkiva - Archive



HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data:
Datum: 24.02.2025
Date:

Njesia organizative	Nr. i Lendes	Vlera
-VI-	020-851/11	

02/2025/1508/12025
Data: 24.02.25
PRISTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Zenun Elezaj , Kryetar i Komunës së Klinës	
Kopje:	Fadil Gashi , Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , Ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Artan Ahemti , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Bora Duli , Ud. Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 	Date: 20/02/2025
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor: Shqiptar Ibra , Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor: Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 	
Lënda:	Shqyrtimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Klinës	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Elezaj,
I nderuari Kryesues z. Gashi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si ne vijim:

<i>Vendimin 01-Nr.06-3885/25 për ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr.06-31721/2020, datë 30.10.2020 për pagesën e shujtave për të punësuarit në administratën e Komunës</i>
<i>I miratuar më datë 31.01.2025</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 11.02.2025</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 18.02.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Klinës, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Komuna e Klinës, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr.06-31721/2020 me qëllim që pagesa e shujtës ditore për punësuarit e Administratës së Komunës së Klinës prej 2.50 euro të rritet në 4.00 euro.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjit 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Për të shqyrtuar aktin komunal në fjalë duhet konsultuar Ligji 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Sipas, akti komunal është i pazbatueshëm duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025 pasi që pagesa e shujtave nuk është përcaktuar me ligj për asnjë organizatë buxhetore sipas paragrafit 5 të nenit 12 të këtij Ligji:

Neni 12

Limitet në zotime dhe shpenzime

5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo

dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës si dhe duke përjashtuar pagesën e profesorëve universitar për ofrimin e shërbimit të trajnimit të mësuesve aktivitet ky i planifikuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Ky trajnim realizohet nga profesorët universitar përkatës në përputhje me marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të MASHTI dhe Universitetit të Prishtinës (Fakultetit të Edukimit), e cila marrëveshje rregullon procedurat, afatet, kriteret, mënyrat e pagesës dhe detajet tjera të nevojshme dhe realizohet në përputhje me ndarjet buxhetore përkatëse në MASHTI.

4. Rrjedhimisht, **akti administrativ i Komunës së Klinës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë është i pazbatueshëm.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Klinës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Shtesa Nr. 02/Kom/150
D. Prot. 452-1/2025
Data Datum 24.02.2025
PRISHTINEJA



HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data Datum 24.02.2025
Njësia organizative Nr. i Lendes Vlera
-VI- 020-9019

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Zenun Elezaj , Kryetar i Komunës së Klinës
Kopje:	Fadil Gashi , Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , Ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahemti , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , Ud. Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Shqiptar Ibra , Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Klinës
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Elezaj,
I nderuari Kryesues z. Gashi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin 01-Nr.06-3900/25 për rritjen e buxhetit, tejkalimin, bartjen dhe shpërndarjen e të hyrave nga viti 2024</i>
<i>I miratuar më datë 31.01.2025</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 11.02.2025</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 18.02.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Klinës, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Komuna e Klinës, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon rritjen e buxhetit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2024, bartjen dhe shpërndarjen e tyre nga viti 2024 në vitin 2025 në shumë prej 150,000.00 euro në kategorinë paga dhe mëditje për pagesën e shujtave për punëtorëve të drejtorive komunale.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjit 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, neni 9, paragrafi 7 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komune ato mjete barten në vitin 2025, si në vijim:

Neni 9

Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak

7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2024 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2024, barten në vitin 2025 me vendim të Kuvendit Komunal.

4. Po ashtu, sipas nenit 27 të Ligjit 03-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ndarjet buxhetore që ndërlidhen me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunës do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal, si në vijim:

Neni 27 Skadimi i ndarjëve buxhetore në fund të viti fiskal

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit; megjithatë, ndarjet buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të një komune do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal.

5. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata ka bërë ndryshimin e planit të buxhetit për vitin 2025 dhe ka bërë bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2024. Në këtë kuptim, Komunave ju lejohet që këto bilance të përdoren për të financuar edhe shpenzimet e vitit aktual.
6. Mirëpo, akti komunal në fjalë i ka destinuar mjetet e bartura në kategorinë pagave dhe mëditjeve për pagesën e shpenzimeve të shujtave të punëtorëve të drejtorive të Komunës. Duke pas këtë parasysh, akti komunal është i pazbatueshëm duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025 pasi që pagesa e shujtave nuk është përcaktuar me ligj për asnjë organizatë buxhetore sipas paragrafit 5 të nenit 12 të këtij Ligji.
7. Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Klinës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Klinës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

Rregullorja 01 Nr. 06-43526/2024 për taksa, tarifa dhe ngarkesa, miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me datë 20.12.2024 ka pranuar nga MAPL, Rregulloren 01 Nr. 06-43526/2024 për taksa, tarifa dhe ngarkesa, miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, datë 20.12.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstaton:

Fusha e Agjencionit kadastral

Tek pjesa që i takon Fushës për Gjeodezi dhe Kadastër, janë vërenjtur të njëjtat gabime (si në përgjigjen e parë që është dhënë nga AKK).

Ku janë bërë përshkrimet nga Udhëzimi i vjetër, shembull në kapitullin (VII) neni 27, pika 5. Tarifa për regjistrimin e pronës sipas vlerës së transaksionit, tek tabelari Përshkrimi: Taksa në bazë të vlerës duhet të hiqet për arsye se me Udhëzimin e ri Administrativ (QRK) Nr.04/2024 Tarifa për Regjistrim të Pronës nuk bëhet në bazë të vlerës së transaksionit por në bazë të aktit, po ashtu duke filluar nga pika 6 deri në pikën 14 duhen të harmonizohet Rregullorja me UA (QRK) Nr.04/2024.

Andaj, ju sugjerojmë që të bëni plotësimin e Rregullores duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.04/2024 Për Tarifat Produktet Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave, duke u mbështetur tek Vendimi nr.53/24 të datës 02.08.2024 i nxjerrë nga Agjensioni Kadastral i Kosovës, Lista e produkteve dhe shërbimeve që Ofrohen nga Zyret Kadastrale Komunale dhe tarifat e përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.04/2024 për Tarifa për Produkte, Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrim të Pronës.



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-3900 2025

Datë: 05.02 2025

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 6 dhe paragrafin 6 të nenit 9 të Ligjit 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Nenit 40 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 20.01.2025 me nr. prot. 01Nr.401-2075/2025, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2025 të mbajtur më datën: 31.01.2025, mori këtë :

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, bartjen dhe shpërndarjen e tyre nga viti 2024 në vitin 2025 në shumë prej **150,000.00 Euro**

2. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 1 të këtij vendimi bartet në kategorinë paga dhe mëditje duke u shpërndarë si në vijim:

Zyra e Kryetarit (16018), shuma prej 17,696.00 €;

Administrata (16318), shuma prej 30,337.00 €;

Inspekcioni (16635), shuma prej 5,899.00 €;

Zyra e Kuvendit (16918), shuma prej 1,936.00 €;

Buxhetimi (17518), shuma prej 17,036.00 €;

Infrastruktura Rrugore (18018), shuma prej 2,904.00 €;

Zjarrfikësit dhe inspektimet (18422), shuma prej 11,422.00 €;

Zyra komunale për komunitete dhe kthim (19590), shuma prej 3,371.00 €;

Bujqësia (47018), shuma prej 4,840.00 €;

Shërbimet Kadastrale (65090), shuma prej 7,584.00 €;

Planifikimi Urban dhe inspekcioni (66395), shuma prej 4,840.00 €;

Shërbimet Kulturore (85018), shuma prej 10,955.00 €;

Administrata (92090), shuma prej 5,056.00 €;

Administrata (73027), shuma prej 1,936.00 €;

Shëndetësia Primare (74050), shuma prej 14,918.00 €;

Shërbimet Sociale-Klinë (75586), shuma prej 9,270.00 €;

Arsyetim: Mjetet e destinuara në kategorinë ekonomike Paga dhe mëditje në shumën prej 150,000.00 € do të përdoren për pagesën e obligimeve të shujtave për punëtorët e drejtorive komunale për vitin 2024.

3. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Arkivi.





Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-3885 2025

Datë: 05.10.2025 2025

Duke u bazuar në nenin 53, 57, dhe 58 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.20/2016, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe shkronjën l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Nenit 40 nën piken 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 20.01.2025 me nr. prot. 01Nr.401-2076/2025, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2025 të mbajtur më datën: 31.01.2025, mori këtë :

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ndryshim-plotësim të vendimit 01Nr.06-31721/2020 i miratuar me datë 30.10.2020 për pagesën e shujtave për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës.
2. Me këtë vendim ndryshohet Neni 1 i vendimit bazë, me anë të së cilit pagesa e shujtës ditore ishte e paraparë në vlerë prej 2.50 euro, pas miratimit të propozimit të Ekzekutivit vlere e shujtës ditore ngritet në 4 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
3. Ky vendim është pjesë vendimit 01Nr.06-31721/2020 i miratuar me datë 30.10.2020 për pagesën e shujtave për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës.
4. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pagesa e shujtës ditore në vlerë prej 4 euro do të bëhet duke filluar nga muaji Janar 2024.
5. Pagesa e shujtave do të bëhet nga kategoria Paga dhe Mëditje sipas programeve përkatëse.
6. Për ekzekutimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
7. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web fagen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

